

Autorët për Shqipërinë:

Alesia GEGUSHI - Monitoruese, Lëvizja MJAFT!

Xheni LAME - Asistent Koordinatore e Programit ActionSEE, Lëvizja MJAFT!

QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI DHE NË RAJON

PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E GJENDJES AKTUALE



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian. Opinonet, gjetjet dhe rekomandimet janë të autor-it/ve dhe nuk përbëjnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve.

Autorët për Shqipërinë:

Alesia GEGUSHI - Monitoruese, Lëvizja MJAFT!
Xheni LAME - Asistent Koorditore e Programit ActionSEE, Lëvizja MJAFT!

QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NË SHQIPËRI DHE NË RAJON

**KY PROJEKT ËSHTË MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA BASHKIMI EUROPIAN.
OPINIONET, GJETJET DHE REKOMANDIMET JANË TË AUTOR-IT/VE DHE NUK PËRBËJNË
DOMOSDOSHMËRISHT PIKËPAMJET E DONATORËVE.**

KORRIK 2018

HYRJJE

Në bashkëpunim me partnerët e rrjetit rajonal të organizatave të shoqërisë civile ActionSEE, Lëvizja MJAFT! ka përgatitur këtë punim mbi politikat, në të cilin janë analizuar nivelet e transparencës dhe llogaridhënies së pushtetit ekzekutiv në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Punimi paraqet rezultate të një kërkimi gjithëpërfshirës, bazuar në metodologji shkencore, kryer nga anëtarë të rrjetit të ActionSEE përgjatë periudhës dhjetor 2017 deri në fund të shkurt 2018. Qëllimi i këtij kërkimi është të prezantojnë një këndvështrim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të pushtetit ekzekutiv, si dhe të kontribuojnë në zbatimin e reformave të ndërmarra për administratën publike, të ndikojë në përforcimin e parimeve të mirëqeverisjes dhe të ndihmojë institucionet në zbatimin më eficient të detyrave të tyre operative.

Ky propozim, së bashku me analizat e bëra për këtë fushë, përfaqëson dokumentin e dytë të llojit të tij, që rrjeti i ActionSEE prodhon. Bazuar në studimin e kryer vitin e shkuar, anëtarët e rrjetit përgatitën rekomandime për përmirësimin e hapjes institucionale të qeverisë.

Mbi bazën e rezultateve të matura në vitin 2016, u hartuan punime, të cilat prezantonin gjendjen e institucioneve të Republikës së Shqipërisë dhe rajonit, duke përfshirë edhe mangësitë që institucionet shfaqin dhe praktikat e mira në këtë fushë. Në vijim të analizave të bëra vitin e shkuar, rekomandime dhe udhëzues janë hartuar për përmirësimin e fushave specifike që ky studim mbulon.

Anëtarët e rrjetit ActionSEE, në këtë studim të rradhës, përmirësuan dhe modifikuan metodologjinë e kërkimit dhe treguesit e saj mbi bazën e rezultateve dhe gjetjeve të monitorimit, zhvilluar vitin e shkuar, duke synuar informacion që do të kontribuojnë në rezultate më të mira të projektit. Qëllimi i përdorimit të treguesve të rinj dhe të përmirësuar është shtimi i një dimensionit të ri në këtë kërkim dhe një qasje më eficiente ndaj përmirësimit të hapjes institucionale në rajon.

Duke zotëruar njohuri, rezultate konkrete dhe analiza të qeverisjes së hapur institucionale në rajon, si dhe duke besuar në përmirësimin e punës së institucioneve të pushtetit ekzekutiv në këtë fushë, të ndikuara nga hapat konkretë të prezantuar në udhëzuesit e përgatitur, synojmë të advokojmë për një nivel më të lartë të qeverisë së hapur në rajon. Për këtë arsye, kërkimit të këtij viti i janë shtuar tregues, të cilët advokojnë për standarde më të larta të transparencës proaktive.

Politika e qeverisjes së hapur duhet të jetë një politikë e zbatuar në të gjitha qeveritë e rajonit dhe duhet të përkufizohet ashtu si politikat e tjera të rëndësishme, dhe jo të vijë si rezultat i një vendimi aktual apo i gjendjes së forcës aktuale në pushtet. Çdo vend i rajonit ka kushtet e tij specifike të sferës politike, në të cilën ai zhvillon qeverisjen e tij të hapur, por një hapësirë e rëndësishme për një operacion të bashkuar rajonal në përmirësimin e gjendjes aktuale, mund të ishte një hap për t'u marrë në konsideratë.

Propozimi ynë i adresohet vendimmarrësve të pushtetit ekzekutiv në vendet e rajonit, në të gjitha nivelet: qeveri, ministri dhe agjenci ekzekutive. Ky punim mund të jetë i dobishëm për përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare dhe për kolegët e organizatave të shoqërisë civile, të cilët punojnë mbi çështje të tilla.

Në mënyrë që të arrihet një dialog publik i cilësive të larta lidhur me këto çështje, do të organizohen një sërë eventesh publike, në të cilat do të dëgjohen opinionet e të gjithë grupeve të të interesuarve dhe do të përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përbashkëta e të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje.

Veç kësaj, gjithashtu do të zbatohen të gjitha parimet e transparencës së kërkimit dhe do të informohen institucionet mbi të gjitha detajet e kryerjes së tij dhe konkluzionet e përshtatura. Jemi në dispozicionin tuaj për të gjitha sugjerimet, kritikak konstruktive dhe diskutimet lidhur me këtë punim!

QEVERISJA E HAPUR E INSTITUCIONEVE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV NGA RAJONI

Bazuar në analizën e bërë mbi një sërë të dhënash të grumbulluara, ngjashmëri dhe dallime janë vënë re për sa i përket situatës së rajonit në këtë çështje.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë, se nga prespektiva e rajonit, qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv nuk është në nivele të kënaqshme. Në vend të progresit të pritshëm në këtë fushë, institucionet e pushtetit ekzekutiv në rajon kanë patur një rezultat më të ulët në

krahasim me vitin e shkuar. Hapja institucionale shënon për afërsisht 38% të plotësisht të treguesve, ku përkatësisht një vit më parë ishte në nivelet 41%.

Theksojmë se kërkimi i zhvilluar gjatë këtij viti kërkonte një nivel më të lartë të hapjes institucionale në krahasim me kërkimin e mëparshëm, për shkak të treguesve të rinj të shtuar për matjen e hapjes institucionale, duke i bërë kriteret më kërkuese. Besojmë se një kërkim i tillë më i thelluar ndikoi në këtë rënie të rezultatit të performancës së pushtetit ekzekutiv. Nga ana tjetër, rezultatet dhe të dhënat e analizuara tregojnë se vetë institucionet nuk kanë kryer asnjë aktivitetet për të zhvilluar hapjen e tyre institucionale, kështu që futja e treguesve të rinj nuk ka ndikuar në rezultatet e ulëta.

Siç është konstatuar në analizat e bëra gjatë vitit 2017, edhe këtë vit, politikat e hapjes institucionale, të shfaqura të qarta, konsistente dhe bazuar në dokumenta strategjikë, nuk ekzistojnë. Të dhënat, gjithashtu, tregojnë se niveli i hapjes institucionale shfaqet në rënie përgjatë niveleve hierarkike të qeverisë dhe strukturave të saj. Secili shtet ka kushtet e tij specifike politike në të cilat zhvillon programet e tij të transparencës dhe hapjes institucionale, të cilat do të shtjellohen në një pjesë të tjetër të këtij dokumenti, por ndërkohë vihet re një hapësirë e rëndësishme bashkëpunimi rajonal për përmirësimin e situatës.

Ulja e përqindjes së hapjes institucionale në nivel rajonal, me përjashtim të Qeverisë së Maqedonisë e cila rezulton me një progres të konsiderueshëm, tregon se institucionet e pushtetit ekzekutiv nuk kanë kryer asnjë aktivitet në zhvillimin e politikës së hapjes së tyre institucionale. Fokusi i aktorëve të ekzekutivit dhe legjislativit në zgjedhjet dhe proceset elektorale në vitin e shkuar, kanë përcaktuar ndikimin në vendosjen e prioritetëve të qeverive të shteteve të rajonit, dhe kërkimi ynë e konfirmoi një fakt të tillë.

Mungesa e qasjeve strategjike ndaj hapjes institucionale është ende e dukshme në vendet e rajonit. Të dhënat sugjerojnë një numër të madh të rasteve kur hapja dhe transparenca e institucioneve nuk manifestohen në dokumenta relevantë (strategji, procedura apo politika të lidhura me çështjen). Megjithatë një numër i vogël institucioneve të pushtetit ekzekutiv kanë dokumente, në të cilat, në njëfarë forme, rregullojnë hapjen e tyre institucionale, praktika nuk shfaqet e njëtrajtshme as

në qasjen e hapjes, as në llojet e dokumenteve apo udhëzimeve që e rregullojnë këtë çështje. Njëtrajshmëria nuk shfaqet as ndërmjet vendeve të rajonit, por as ndërmjet institucioneve të pushtetit ekzekutiv të një shteti të vetëm, gjithashtu.

As prezenca e nismave ndërkombëtare, të cilat advokojnë hapjen institucionale në vendet e rajonit, nuk ka kontribuar në rritjen e hapjes dhe transparencës institucionale të institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Mungesa e politikave të brendshme dhe aspiratave për të punuar në përmirësimin e këtyre fushave është reflektuar qartësisht në anëtarësimin e vendeve në nisma të tilla.

Mungesa e vullnetit të institucioneve të pushtetit ekzekutiv të vendeve të rajonit për të punuar në përmirësimin e hapjes dhe transparencës institucionale, u konfirmua edhe nga numri i ulët i institucioneve, të cilat ishin pjesë aktive e kërkimit të zhvilluar dhe përgjigjeve të marra nga pyetësorët e dërguar, pjesë kyçe e gjithë studimit, në krahasim me vitin e shkuar. Mungesa e dëshirës për t'i kthyer përgjigje pyetësorit është, në vetvete, një tregues i rënies së hapjes institucionale dhe mungesë interesi në promovimin e kësaj nisme.

Rekomandimet për përshtatjen e dokumentave strategjik dhe planeve vjetorë të veprimit, të cilët adresojnë zhvillimin e hapjes institucionale, mbeten ende. Brenda shteteve është i rëndësishëm planifikimi i zhvillimit, por edhe sigurimi i njëtrajshmërisë së hapjes institucionale të institucioneve të pushtetit ekzekutiv. Pas prezantimit të planit strategjik është i rëndësishëm të konsiderohet miratimi i ligjit “Për qeverinë dhe ministrinë”, duke qenë se një i tillë do të prezantonte një mënyrë eficiente të trajtimit të çështjes së hapjes institucionale, por edhe çështje të tjera të cilat lidhen me funksionimin e administratës publike. Bazuar në monitorimin e bërë, disa “pika kritike” do të parashtrohen, duke nënkuptuar ato pengesa kritike që shfaqen për zhvillimin e politikës së hapjes institucionale në rajon.

Transparenca dhe komunikimi

Edhe pse ekzistojnë shembuj të praktikave të mira në zbatimin e ligjeve për të drejtën e informimit ndërmjet institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon, ato nuk janë të përhapura shumë gjerësisht, madje as brenda një vendi të vetëm. Institucionet e qeverisë ende ushtrojnë vullnetin e

tyre në përcaktimin e niveleve në të cilat, ligjet e sipërpërmendura, duhet të zbatohen, dhe nuk po ndërmerren hapa drejt avancimeve ligjore që ofrojnë transparencë proaktive, publikimin e rregjistrave dhe udhëzuesve për të drejtën e informimit, si dhe publikimin e të gjitha përgjigjeve kundrejt kërkesave për infomacion publik.

Komunikimi me qytetarët është shumë larg rezultateve të kënaqshme. Në të ardhmen pritet ndërmarrja e aktiviteteve të rëndësishme për përmirësimin e situatës aktuale. Mënyrat moderne të komunikimit me qytetarët paraqesin një situatë të pandryshuar; metodat klasike të komunikimit prevalojnë ende. Një problem tjetër rajonal mbetet edhe respektimi i parimit të publikimit të formatit open data , i cili do të rriste disponueshmërinë dhe do të lehtësonte përdorimin e të dhënave nga qytetarët.

Planifikimi dhe shpenzimi i fondeve publike

Praktika e publikimit të informacionit dhe dokumentave financiarë është ende e pauniformizuar dhe transparencja e shpenzimeve të fondeve publike është në nivele ekstremisht të pakënaqshme. Forcimi i transparencës financiare duhet të jetë në fokus, si dhe një nga prioritetet e ardhshme të institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon, gjë e cila kërkon një përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim.

Informacionet mbi buxhetin, por edhe informacionet mbi mënyrën sesi fondet e planifikuara janë shpenzuar, rrallë janë të publikuara në faqet zyrtare të institucioneve. Ministritë e Financave të vendeve të rajonit janë, në shumicën e rasteve, institucionet që kanë të publikuara këto të dhëna, ndërsa institucionet e tjera të pushtetit ekzekutiv, thuajse fare apo pjesërisht. Buxheti për qytetarët dhe mundësia që qytetarët të jenë të përfshirë në procesin e planifikimit dhe shpenzimit të fondeve publike është një praktikë e panjohur për institucionet rajonale të pushtetit ekzekutiv.

Gjithashtu, praktika e mospublikimit të planeve për prokurime publike është ende masivisht prezente, ndërkohë që thirrjet dhe vendimet lidhur me procedurat e prokurimeve dhe kontratave përkatëse dhe shtojcave të marrëveshjeve nuk janë të disponueshme në shumicën e rasteve.

1) Open data janë të dhëna të strukturuar në formate të kuptueshme kompjuterike, të cilat janë mundësinë e përdorimit të vazhdueshëm.

Efiçenca, efektiviteti dhe pritshmëritë e qytetarëve ndaj pushteteve

Një pyetje e rëndësishme e funksionimit të pushtetit ekzekutiv dhe hapjes së tij ndaj qytetarëve është krjimi i treguesve të qartë të suksesit të politikave qeveritare, të cilat do të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe sipas të cilave, qytetarët mund të monitorojnë realizimin e këtyre politikave dhe shkallën e tyre të suksesit.

Qeveritë rajonale duhet të ndërtojnë metoda dhe procedura për kontroll të cilësisë së lartë të politikave të tyre, ndërkohë që mungojnë metodat për matjen e performancës së këtyre politikave. Vëmendje e mjaftueshme nuk i është kushtuar përcaktimit të një metode të vetme, përmes të cilës ministrinë informojnë qeverinë për aktivitetin e tyre vjetor. Të gjithë treguesit shënojnë negativisht informimin e qytetarëve mbi ndikimin dhe efektet e operacioneve të kryera nga pushteti ekzekutiv.

Qeverisja e hapur e pushtetit ekzekutiv në Shqipëri

Në matjet e bëra gjatë periudhës për këtë studim, pushteti ekzekutiv shqiptar shënon 36% të përmbushjes së treguesve të qeverisjes së hapur. Duke iu referuar matjeve të mëparshme, ky rezultat është i përafërt me rezultatin e shkuar të këtij pushteti në çështjet e hapjes institucionale. Anëtarësia e vendit tonë në Open Government Partnership dhe disa nisma të qeverisë për bashkëqeverisje dhe llogaridhënie qytetare vijojnë zbatimin e politikës për qeverisje të hapur.

Përgjatë viteve të fundit, presion i lartë po ushtrohet nga organizatat e shoqërisë civile, që kanë në fokus të tyre çështjet e mirëqeverisjes, të cilat bashkëpunojnë ngushtë me zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së pushteteve ndaj qytetarëve. Ky aksion mbështet në ligjin për të drejtën e informimit², një ligj i cilësuar si i mirëhartuar, i cili që prej fillimit të këtij viti po diskutohet të rishikohet nga zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke parashikuar, ndër tjera, edhe shkurtimin e ditëve të lejuar për kthimin e përgjigjes nga ana e institucioneve.

Viti 2017 ishte viti i zgjedhjeve qendrore në Shqipëri. Një mandat i dytë i qeverisë së mëparshme, me një kabinet të ri ministror dhe shkrirje agjencish ekzekutive, reflektoi një sërë gjetjesh në këtë studim, duke sjellë ngjashmëri dhe dallime krahasuar me studimin e një viti më parë.

Ajo çka vihet re edhe në këtë studim është zvogëlimi i nivelit të hapjes institucionale përgjatë hierarkisë së institucioneve të pushtetit ekzekutiv². Mungesa e stafeve të kualifikuara dhe të njohura me politikën e transparencës, si dhe mospublikimi i personave përgjegjës për zbatimin e saj vazhdojnë të jenë problematikë e sistemit. Kjo na dëshmon se puna për zbatimin e parimeve të qeverisjes së hapur, ndryshimin i mentalitetit të administratorëve publikë për të ofruar informacion ndaj qytetarëve dhe gatishmërinë e institucioneve për të përfshirë publikun në proceset e vendimmarrjes duhet të vazhdojë të mbetet në fokus për t'u testuar, trajtuar dhe rehabilituar.

2) Ligji Nr. 119/2014, datë 18.9.2014 "Për të drejtën e informimit"

3) Qeveria shqiptare arrin 55% të kriterëve të qeverisjes së hapur, Ministrinë plotësojnë afërsisht 42%, ndërsa Agjencitë Ekzekutive arrijnë 21% të të gjitha kriterëve.

QEVERIA E SHQIPËRISË

Me një zbritje prej 3% krahasimisht me matjet e mëparshme, Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka performuar afërsisht 55% të hapjes institucionale. Edhe pse vlerësimi përkon me mesataren e performancës së rajonit, nuk përfaqëson nivel të kënaqshëm për zbatimin e politikës së hapjes institucionale, në krahasim kjo me standardet ndërkombëtare në të cilët studimi ynë është bazuar.

Bazuar në katër shtyllat mbi të cilat është ngritur ky studim, qeveria shqiptare ka shënuar me 75% plotësimin e treguesve të efektshmërisë, 72% plotësimin e treguesve të aksesueshmërisë, 55% treguesit e integritetit dhe 40% transparencë. Vëmë re se çështjet e konfliktit të interesit, kodit të etikës, lobingut, transparencës buxhetore dhe prokurimeve publike paraqesin vlerësim të ulët nga monitorimi i bërë. Në faqen zyrtare të qeverisë shqiptare nuk gjendet asnjë informacion në lidhje me transparencën buxhetore të qeverisë apo edhe të shtetit. Mungojnë tabelat fillestare të buxhetit, raportet e ndërmjetme të shpenzimeve buxhetore, gjendja e borxhit publik, si dhe tabelat e shpenzimeve faktike vjetore në krahasim me planifikimet e bëra. Madje, është vënë re se nuk ka asnjë dokument që vërteton depozitimin në kohë nga kryeministria të draftit të buxhetit vjetor pranë administratës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kohë kjo e përcaktuar tre muaj

përpara fillimit të diskutimeve në komisione parlamentare. Gjithashtu, e njëjta situatë paraqitet edhe me treguesit që lidhen me prokurimet publike. Çdo informacion i lidhur me thirrjet për prokurime, rezultatet e procedurave, kontratat e nënshkruara dhe shtojcat e dakordësuara, publikimin e prokurimeve me vlera të mëdha, prokurimet faktike në krahasim me rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, mungon në faqen e kryeministrit. Qeveria shënon shifrat 0 të hapjes institucionale kur flasim për veprimtari që lidhen me paratë e shtetit.

Krahas transparencës, integriteti ka patur një performancë të ulët, gjithashtu. Ajo që sërish është vënë re në këtë matje performance është mungesa e një ligji apo e ndonjë nisme ligjore për të rregulluar aktivitetet lobuese në Shqipëri. Veç kësaj, qeveria nuk ka të publikuar një plan konkret integriteti apo ndonjë strategji/politikë antikorrupsion. Rishikimi i udhëzuesve për ushtrimin e të drejtës së informimit është një nga treguesit e hapjes institucionale ndaj qytetarëve dhe aktorëve të tjerë që punojnë me institucionet publike. Ky udhëzues është i papërditësuar në faqen e kryeministrit, ku për më tepër, mungon edhe emri i personit përgjegjës për ushtrimin e funksionit të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit për këtë institucion.

Sa i takon punimeve të kabinetit ministror, rezultate jo pozitive kanë shënuar edhe publikimet e materialeve dhe agjendave të takimeve qeveritare. Nuk ka publikim të përjavshëm të planeve të kryeministrit për realizimin e mbledhjeve me kabinetin qeveritar, mungojnë agjendat për sesionet e ardhshme qeveritare, mbledhjet vijnë të bëhen me dyer të mbyllura pa praninë e mediave dhe nuk publikohen procesverbalet e diskutimeve në këto mbledhje. Dokumentat me përmbajtjen e planeve vjetore të punës apo formatet sesi dhe çfarë informacionesh ministritë duhet të raportojnë ndaj kryeministrit, janë tregues që kanë shënuar vlerën 0 të aksesueshmërisë.

Në aspektin organizativ, emrat e nëpunësve civilë dhe zyrtarëve publikë, shoqëruar me funksionet dhe mënyrat e kontaktit, janë pjesërisht të publikuar në faqen zyrtare të qeverisë shqiptare. Të dhënat mbi pasuritë e zyrtarëve, si dhe paraqitja e një formati të strukturuar për të pasqyruar qartë pasuritë e tyre, mungojnë në faqen e kryeministrit, gjithashtu.

Ministritë

Ministritë e Republikës së Shqipërisë kanë performuar 42% të plotësisimit të treguesve të hapjes institucionale. Në këto matje të bëra janë vlerësuar 11 ministri, krahasimisht me 18 ministritë e vlerësuara në matjet e shkuara. Me mandatin e dytë të qeverisë “Rama”, kompetencat e dy apo tri ministrive u shkrinë në një të vetme, duke e tkurrur kështu madhësinë e qeverisë dhe duke rritur përgjegjësitë brenda një institucioni të vetëm.

Performanca sipas katër shtyllave të mirëqeverisjes për këto ministri është: 44% plotësimin e treguesve të aksesueshmërisë, 42% transparencë, 41% treguesit e integritetit dhe 40% të treguesve të efektshmërisë. Për këto komponentë, ministria e cila ka rezultuar me performancën më të mirë është ajo e Kulturës me 75.7%, ndërsa me performancën më të ulët rezultoi Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Zhvillimi i konsultimeve publike mbetet ende një çështje që duhet adresuar për t'i kushtuar më shumë vëmendje nga ministritë e linjës, duke shënuar vlerën 9% të zbatimit. Edhe pse jemi në vitin e katërt të miratimit të ligjit “Për njoftim dhe konsultim publik”⁴, rezultatet vazhdojnë të jenë të pakënaqshme.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës janë të vetmet ministri që kanë caktuar dhe publikuar koordinatorin për konsultimet publike⁵. Megjithatë, këto ministri nuk kanë realizuar asnjë takim me grupet e interesuara për të qenë pjesë e hartimit të politikave publike.

Sikurse ligji parashikonte, konsultimet publike do të zhvilloheshin në një platforme të vetme për të gjitha nismat e institucioneve publike, duke paraqitur njoftimin për konsultim dhe dokumentat e nevojshme për realizimin efektiv të procesit. Duke bërë vëzhgimin e platformës konsultimepublike.gov.al⁶ u vu re se lista e institucioneve nuk është e përditësuar, si me informacione për konsultime publike, ashtu edhe me ndryshimin e emërtimeve të institucioneve publike.

4) Ligji Nr.146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftim dhe konsultim publik”

5) Neni 10, Koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik, Ligji Nr.146/2014, datë 30.10.2014 “Për njoftim dhe konsultim publik”

6) <http://www.konsultimipublik.gov.al/>

7) <http://app.gov.al/>

Një tjetër tregues, Monitorim dhe Vlerësim, ka shënuar rezultat të ulët, me vlerë 27.3%. Është vënë re se treguesit që përdornin ministritë e linjës, shpesh shfaqeshin të paqartë dhe jo specifikë për të matur performancën e nëpunësve civilë.

Një mënyrë për të vlerësuar transparencën institucionale ndaj qytetarëve është edhe kontrolli i publikimit të transparencës buxhetore, duke përfshirë disa indikatorë të lidhur me buxhetin vjetor, shpenzimet vjetore, raportet e ndërmjetme vjetore të buxhetit, procedurat e prokurimeve publike që ka zhvilluar institucioni gjatë vitit 2017. Nga matjet e bëra ka rezultuar se vetëm 34% e ministrive publikojnë buxhetet e tyre institucionale dhe 11.5% publikojnë informacione në lidhje me prokurimet publike. Ministria e Financës dhe Ekonomisë është ajo e cila publikon informacionet buxhetore për të gjitha institucionet publike, ndërsa shfaqen pesë ministri, si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, që nuk mbartin asnjë informacion buxhetor në faqet e tyre zyrtare.

Ndërkohë, procedurat e prokurimeve publike vazhdojnë të realizohen në mënyrë qendrore nga Agjencia e Prokurimeve Publike⁷, ku secili institucion publik zotëron llogari personale për publikimin e prokurimeve që i takojnë këtij të fundit. Qytetarët, përmes një kërkimi të avancuar, mund të shohin thirrjet për prokurime që autoritetet kontraktuese, në këtë rast, institucionet shtetërore, publikojnë në këtë platformë.

Agjencitë Ekzekutive

Agjencitë Ekzekutive të Republikës së Shqipërisë kanë performuar 21% të hapjes institucionale. Agjencia Kombëtare e Turizmit ka shënuar vlerën më të lartë prej 47% të plotësimit të treguesve, ndërsa Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, Agjencia Rajonale e Sistemit Shëndetësor dhe Agjencia Kombëtare e të Ardhurave shënojnë negativisht në respektimin e parimeve të mirëqeverisjes, me 0% hapje institucionale.

Performanca sipas katër shtyllave të mirëqeverisjes për agjencitë e përzgjedhura në kampionin e matjeve është: 27% plotësimi i treguesve të efektshmërisë, 22% treguesit e aksesueshmërisë, 21% transparencë dhe

7% treguesit e integritetit.

Rreth 29% e këtyre institucioneve nuk kanë ngritur një faqe zyrtare online; ndërkohë ato agjenci që kanë një faqe zyrtare, shënojnë vlera shumë të ulëta sa i takon aksesimit të informacionit, me vetëm 28% të treguesve të plotësuar, dhe ndërveprimin qytetar me 15% të treguesve të hapjes institucionale.

Sa i takon politikave të brendshme antikorupsion dhe trajnimeve të mbajtura për çështjet e konfliktit të interesit, parandalimit të korrupsionit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, agjencitë kanë shënuar 7% të plotësisimit të treguesve të integritetit.

Transparenca buxhetore e Agjencive Ekzekutive në Shqipëri është gjithashtu në vlerën 7%, e cila vjen si rezultat i mospërditësisimit të faqeve zyrtare, si dhe mungesës së tabelave buxhetore vjetore apo të paqartësisë së tyre për publikun e gjerë.

Prokurimet publike janë po ashtu një komponent shqetësues për sa i takon performancës së agjencive, me rreth 7% të plotësisimit të treguesve të transparencës institucionale. Ashtu sikurse gjithë institucionet qendrore, edhe Agjencitë Ekzekutive i drejtohen Agjencisë së Prokurimeve Publike për realizimin e procedurave të prokurimit.

Metodologjia e kërkimit

Qeverisja e hapur përfaqëson një kusht kyç të demokracisë pasi kjo u lejon qytetarëve të marrin informacion dhe njohuri të nevojshme për pjesëmarrje të barabartë në jetën politike, vendim-marrje efektive dhe pasjen e institucioneve të përgjegjshme për politikën të cilat ato ndjekin.

Ndërkombëtarisht, institucionet ndërmarrin aktivitete të ndryshme me qëllim rritjen e transparencës së tyre dhe llogaridhënien te qytetarët. Indeksi Rajonal për Qeverisjes e Hapur të pushtetit ekzekutiv është ndërtuar në qëllim të përcaktimit se në cilën shkallë qytetarët e Ballkanit Perëndimor marrin dhe kuptojnë informacionin e institucioneve të tyre.

Indeksi Rajonal i Qeverisjes së hapur mat shkallën në të cilën institucionet e Ballkanit Perëndimor janë të hapura për qytetarët dhe shoqërinë, dhe ai bazohet në katër parimet bazë si vijon:

1) Transparenca 2) Aksesueshmëria 3) Integriteti dhe 4) Efektshmëria Parimi i transparencës përfshin informacionin organizativ, buxhetin dhe procedurat e prokurimeve publike të cilat janë në dispozicion të publikut dhe të publikuara. Aksesueshmëria është e lidhur me sigurimin dhe respektimin e procedurave për akses të lirë në informacion, duke përmirësuar disponueshmërinë e informacionit përmes mekanizmave të debatit publik dhe forcimin e ndërveprimit me qytetarët. Integriteti përbëhet nga mekanizmi i parandalimit të korrupsionit, mbajtjen e kodit etik dhe rregulloret e lobimit. Parimi i fundit, Efektshmëria i referohet monitorimit dhe vlerësimit të politikave të zbatuara nga institucionet.

Duke ndjekur standardet ndërkombëtare, rekomandimet sikurse dhe shembuj të praktikave të mira, këto parime janë zhvilluar më tej përmes treguesve specifik cilësorë dhe sasiorë, të cilët janë vlerësuar në bazat e: aksesueshmërisë së informacionit në websitet zyrtare të institucioneve, shqyrtimin e kuadrit ligjor për çështje të veçanta, burimeve të tjera të informacionit publik dhe pyetësorëve të dorëzuar në institucione.

Përmes rreth 180 treguesve, kemi matur dhe analizuar hapjen institucionale të institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe janë mbledhur më shumë se 10,000 të dhëna. Mbledhja e të dhënave është pasuar nga procesi i verifikimit, ku rezultoi një devijim standard prej +/-3%. Matjet janë kryer gjatë periudhës dhjetor 2017 deri në fund të shkurt 2018.